

# PROJEKT-KUSHTETUTË PËR DARDANINË

Draft: 2015-02-09

Getoar Mjeku ([gm@getoar.com](mailto:gm@getoar.com))

## PARATHËNIE

Ne, Populli i Dardanisë së lirë e të pavarur, — lidhë besa-besë për me mbrojtë jetën me nder e të lirë të secilit njeri, pa dallim; për me i rujtë doket, gjuhën, dhe vetëvetësinë tonë kombëtare; dhe për me jetësu vegimin e të parëve tanë për dheun stërgjyshor dhe ëndrrat e të gjithë brezave që vijnë, tue ndërtu një shtet të drejtë, përparimtar, e të fuqishëm, që do të rrojë denjësisht në gjirin e kombeve paqedashëse të Evropës së Bashkuar; tash e sa të ketë mot — shpallim e vendojmë këtë Kushtetutë.

## KREU I. PARIME THEMELORE

### PJESA 1. SHTETI

#### Neni 1. Përcaktimi

- Dardania është vend i lirë dhe shtet i pavarur, sovran, dhe i njëshëm, me tërësi tokësore të pacenueshme dhe të patjetërsueshme.
- Shteti dardan është republikë demokratike, shoqërore, dhe shekullare. Shteti dhe republika janë themeluar nga populli për t'i mbrojtë të drejtat themelore dhe për të vepruar vetëm për të mirën e popullit.
- Popullin e përbëjnë Kombi Shqiptar si dhe të gjitha kombësitë dhe qytetarët dardanë pa dallim.

#### Neni 2. Sovraniteti popullor

- Shteti dhe sovraniteti i përkasin përherë popullit. Populli e ushtron sovranitetin vetëm në mënyrat që i parasheh vetë me Kushtetutë.
- Populli lidh besën se do t'i mbrojë përjetësisht dhe me të gjitha mjetet sovranitetin e vet dhe të drejtat themelore. Për aq kohë sa e mban besën e dhënë, populli mund t'i bëjë Kushtetutës çfarëdo ndryshimi dhe kurdo që e sheh të vyeshme.

**Neni 3. Qeverisja**

1. Populli përligj organet shtetërore përmes zgjedhjeve të lira e të periudhshme.
2. Organet shtetërore veprojnë duke u mbështetë në ndarjen dhe baraspeshimin e pushteteve ligjvënës, përbarimor, gjyqësor, dhe të posaçëm.

**PJESA 2. LIGJSHMËRIA****Neni 4. Shteti ligjor**

1. Çdo njeri dhe vetë juridike i nënshtrohet Kushtetutës dhe ligjeve tjera.
2. Kushtetuta dhe rendi ligjor nuk mund të pezullohen në asnjë rrethanë.

**Neni 5. Epërsia e Kushtetutës**

1. Kushtetuta është ligji më i lartë i vendit. Të gjitha ligjet duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën.
2. Kushtetuta nuk mund të ndryshohet ose shfuqizohet, përveçse në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë.

**Neni 6. E drejta ndërshtetërore**

1. Dardania zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme. Marrëveshjet ndërshtetërore të ratifikuara janë ligj i vendit dhe marrin përparësi ndaj ligjeve tjera, me përjashtim të Kushtetutës.
2. Aktet ligjore e nënligjore të një organizate mbarëkombëtare, sipërkombëtare, ose ndërkombëtare mund të marrin përparësi ndaj ligjeve vendase, me përjashtim të Kushtetutës.

**Neni 7. Burimet e ligjvënies**

1. Kushtetuta, e drejta ndërshtetërore, e drejta dokesore shqiptare, e drejta bashkënore evropiane (*Acquis communautaire*), dhe vullneti i popullit janë burim i vetëm i ligjvënies.
2. Traditat dhe librat fetarë nuk mund të jenë burim i ligjvënies ose ligjit.

**PJESA 3. VETËVETËSIA SHTETËRORE****Neni 8. Vetëvetësia evropiane**

1. Dardania është pjesë historike dhe kulturore e bashkësisë së kombeve të Evropës.
2. Shteti nxit bashkëpunimin mes vendeve të Evropës në të mirë të paqes, demokracisë, drejtësisë, dhe përparimit ekonomik të qytetarëve evropianë.

**Neni 9. Kombi Shqiptar**

1. Dardania është pjesë e pandashme e Kombit Shqiptar.
2. Shteti nxit bashkëpunimin mbarëkombëtar dhe mbron interesat e shqiptarëve jashtë Dardanisë.

**Neni 10. Gjuhët**

1. Shqipja është gjuha zyrtare e shtetërore dhe ka përparësi ndaj gjuhëve tjera.

2. Organet shtetërore mund ta përdorin, sipas nevojave të qytetarëve, cilëndo gjuhë trashëgimisht të folur në Dardani. Këto gjuhë përfshijnë, por jo vetëm, gjuhët shqiptare dhe dardane të shenjave, sërbshten, turqishten, boshnjakishten, romishten, malazezishten, dhe çerkezishten.

3. Organet shtetërore mund të përdorin një gjuhë të huaj vetëm në marrëdhënie ndërkombëtare ose sipërkombëtare ose kur atë e kërkon ndarja e drejtësisë.

#### **Neni 11. Simbolet**

1. Organet shtetërore dhe qytetarët mund të përdorin, sipas ligjit, flamurin kombëtar shqiptar, flamurin shtetëror, si dhe simbole tjera për ta përfaqësuar Dardanisë.

2. Flamuri shtetëror ngërthen një shfaqësim të flamurit kombëtar të stolitur me shenja dalluese të trashëgimisë dardane.

#### **Neni 12. Kryeqyteti**

1. Kryeqyteti i Dardanisë dhe selia e organeve qendrore është Prishtina.

2. Selia e organeve të bashkëpunimit mbarëkombëtar është Prizreni.

## **KREU II. TË DREJTAT THEMELORE**

---

### **PJESA 1. PARIME TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 13. Përcaktimi**

1. Të drejtat themelore janë të gjithësishme, të pandashme, të pacenueshme, dhe të patjetërsueshme, dhe përbëjnë themelin e rendit ligjor.

2. Të drejtat themelore vlejné, për aq sa janë të zbatueshme, për të gjithë njerëzit dhe vetat juridike.

3. Çdonjëri ka detyrë t'i respektojë të drejtat themelore.

#### **Neni 14. Kufizimi i ligjshëm**

1. Ndalohet çdo përpjekje me shkelë një të drejtë themelore.

2. Një e drejtë themelore nuk mund të kufizohet pos me ligj dhe vetëm për aq sa kufizimi është i domosdoshëm për të mbrojtë vendin, rendin kushtetutor, ose të drejtat e të tjerëve.

3. Kufizimi i një të drejte themelore nuk mund ta mohojë thelbin e saj ose të tejkalojë kufizimet e lejuara nga mjetet mbarevropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

4. Kur kufizohet një e drejtë themelore, organet shtetërore shqyrtojnë mundësinë me arritë qëllimin me kufizim më të vogël, duke i kushtuar vëmendje:

(1) thelbit të së drejtës që kufizohet;

(2) rëndësisë së qëllimit të kufizimit;

(3) natyrës dhe vëllimit të kufizimit; dhe

(4) përputhjes midis kufizimit dhe qëllimit të kufizimit.

## **PJESA 2. TË DREJTAT VETJAKE**

### **Neni 15. Jeta dhe denjësia**

1. Çdonjëri ka të drejtë për të jetuar, me denjësi dhe që nga ngjizja.
2. Askujt nuk mund t'i merret jeta për gjak ose për përmbarrimin e një dënimi me vdekje.

### **Neni 16. Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar**

1. Askush nuk mund të mbahet në skllavëri ose robëri.
2. Askush nuk mund të shtrëngohet me bë punë të detyruar. Nuk quhet punë e detyruar:
  - (1) puna ose shërbimi i përcaktuar me ligj për të dënuarit me vendim të prerë;
  - (2) shërbimi në Ushtri ose shërbimi për mbrojtjen e vendit; ose
  - (3) shërbimi i përcaktuar me ligj për rastet e masave të jashtëzakonshme.

### **Neni 17. Ndalimi i torturës dhe trajtimit jonjerëzor**

Askush nuk mund t'i nënshtrohet:

- (1) shitjes ose trafikimit;
- (2) rrahjes ose torturës; ose
- (3) trajtimit a ndëshkimit mizor, çnjerëzor, poshtëruës, a gjymtues.

### **Neni 18. Barazia**

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe gëzojnë mbrojtje të barabartë ligjore.
2. Ndalohet trajtimi i pabarabartë ose nxitja e mosdurimit për shkaqe të gjinisë, seksit, orientimit seksual, racës, ngjyrës, kombësisë, prejardhjes, gjuhës, të folmes, fesë, bindjeve shpirtërore, fisit, derës, familjes, pronës, gjendjes amvisnore a shoqërore, trevës, vendbanimit, mërgimit ose arsimimit jashtë vendit, mendimit, shoqërimit, amësisë, lindjes, parbinisë, moshës, sëmundjes, aftësisë së kufizuar, ose ndonjë gjendjeje tjetër.
3. Shteti mbron dhe ndihmon të përparojnë ata që, për shkak të padrejtësive shoqërore, janë në gjendje të pabarabartë.

### **Neni 19. E drejta e tërësisë vetjake**

Çdonjëri ka të drejtën e tërësisë trupore dhe mendore. Kjo e drejtë përfshin të drejtën:

- (1) për të marrë vendime lidhur me shtimin, sipas rregullave të përcaktuara me ligj, por pa ua cenuar të drejtën për jetë vetëve të palindur;
- (2) për të pasë kontroll mbi trupin e vet;
- (3) për të mos iu nënshtuar trajtimit mjekësor kundër vullnetit të vet; dhe
- (4) për të mos marrë pjesë, pa dhënë pëlqimin e vet paraprak, në eksperimente mjekësore ose shkencore.

**Neni 20. E drejta e privatësisë**

1. Askujt nuk mund t'i cenohet hapësira vetjake, jeta private, banesa, objektet private, kumtimi, ose të dhënat vetjake.
2. Asnjë banesë, objekt privat, ose kumtim nuk mund të bastiset, përveçse me miratim gjyqësor dhe për aq sa lejon miratimi.
3. Gjykata miraton bastisjen paraprakisht, me shkrim, dhe vetëm për aq sa bastisja është e domosdoshme për hetimin e një shkeljeje të ndëshkueshme. Gjykata përshkruan saktësisht vendin ose njeriun që do të kontrollohet dhe sendin që do të merret.
4. Gjykata miraton bastisjen prapaveprimisht nëse bastisja është e domosdoshme:
  - (1) për ta ndalë dikë ligjshëm;
  - (2) për të mbledhë prova që ka rrezik të humbin; ose
  - (3) për ta mënjanuar rrezikimin e drejtpërdrejtë dhe të rëndë ndaj njerëzve ose pronës.

**Neni 21. E drejta e besës**

1. Shteti është përgjegjës për sigurinë botore.
2. Çdonjëri ka të drejtën e besës se askush përpos shtetit nuk do ta përndjekë për kryerjen e një shkeljeje të ndëshkueshme.
3. Shteti dënon dhe mund t'i shpronësojë ata që shkelin të drejtën e besës.

**Neni 22. Liria digjitore**

Asnjëri nuk mund të detyrohet që, për të gëzuar të drejtat e veta, të përdorë ose të paguajë për mjete, ndërtimin e brendshëm të të cilave nuk mund ta qasë, ndryshojë, ose shpërndajë lirshëm.

**Neni 23. Heqja e lirisë**

1. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse sipas ecurisë ligjore, nën dyshimin e arsyeshëm se ka krye një shkelje të ndëshkueshme ose kur dënohet me vendim të prerë gjyqësor.
2. Organi përgjegjës mund të mbajë një të mitur nën mbikëqyrje edukuese ose kujdestari për t'ia mundësuar shoqërimin a kujdesin e nevojshëm.
3. Organi përgjegjës mund të mbajë nën mbikëqyrje shëndetësore një njeri që për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë.
4. Askujt nuk mund t'i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të lajë borxh ose të përmbushë një detyrim kontrate.

**Neni 24. Ndalja e ligjshme**

1. Çdonjërit që i hiqet liria njoftohet menjëherë, në një gjuhë që e kupton:
  - (1) pse po i hiqet liria si dhe për ngarkesat ndaj tij;
  - (2) se nuk është i detyruar me dhënë deklaratë; dhe
  - (3) se ka të drejtë të kumtojë me një mbrojtës, që e zgjedh vetë ose ia caktojnë, dhe me më të afërmit.

2. Çdonjëri që ngarkohet me shkelje të ndëshkueshme njoftohet me kohë, në një gjuhë që e kupton dhe në hollësi, rreth natyrës dhe shkakut të ngarkesave që i bëhen dhe për të drejtat e të ngarkuarit.

#### **Neni 25. Masat para gjykimit**

1. Çdonjëri që i hiqet liria pa urdhër gjyqësor duhet të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në pritje të gjykimit. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e një dorëzanie pasurore.
2. Askush nuk mund të mbahet në paraburgim në pritje të gjykimit, përveçse nën vlerësimin e mbështetur se i mbajturi përbën rrezik për rrethin ose se ka rrezik se i mbajturi nuk do të paraqitet në gjykim.
3. Çdonjëri që i hiqet liria pa urdhër gjyqësor sillet, brenda 48 orëve dhe pa vonesë të paarsyeshme, para një gjyqtari. Brenda 48 orëve vijuese, gjyqtari merr vendim me shkrim dhe të arsyetuar me liru ose me paraburgu të mbajturin.
4. I paraburguari ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit.

#### **Neni 26. Mjetet juridike**

1. Çdonjëri ka të drejtë t'i kërkojë një gjyqtari me vlerësu ligjshmërinë e heqjes së lirisë së kujtdo. Gjyqtari përmbush kërkesën brenda 48 orëve dhe, nëse vlerëson se heqja e lirisë është e jashtëligjshme, urdhëron me liru të mbajturin.
2. Çdonjërit që i hiqet liria në kundërshtim me shqitjet e kësaj pjese i takon dëmshpërblimi.
3. Çdonjëri ka të drejtë që, sipas ligjit, të ankohet për kushtet e heqjes së lirisë së kujtdo.

### **PJESA 3. ECURIA E DREJTË LIGJORE**

#### **Neni 27. Gjykimi i ndershëm**

1. Çdonjëri ka të drejtën e gjykimit të ndershëm, në përcaktimin e të drejtave e detyrimeve qytetnore dhe përgjegjësisë për një shkelje të ndëshkueshme. Kjo e drejtë përfshin shqyrtimin e hapur, të drejtë, dhe të paanshëm, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, dhe e themeluar me ligj.
2. Çdonjëri ka hak qasjen në të gjitha të dhënat zyrtare që janë të domosdoshme për të mbrojtë ose gëzuar një të drejtë të veten.
3. Aktgjykimi jepet i arsyetuar dhe shpallet botërisht.

#### **Neni 28. E drejta e mbrojtjes**

1. Askush nuk mund të gjykohet për një shkelje të ndëshkueshme pa pasë kohë e mjete të mjaftueshme me përgatitë mbrojtjen.
2. Çdonjëri që ngarkohet me shkelje të ndëshkueshme ka gjithashtu:
  - (1) hak çdo provë ose të dhënë që ndodhet në zotërim të shtetit dhe dëshmon ose mbështet pafajësinë e të ngarkuarit, shfaqëson të ngarkuarin, ose ndihmon me lehtësu dënimin;
  - (2) hak ndihmën e veshme të mbrojtësit dhe të drejtë të kumtojë lirisht e privatisht me mbrojtësin;
  - (3) të drejtë të mbrohet, vetë ose përmes mbrojtësit;

- (4) të drejtë që, vetë ose përmes mbrojtësit, t'i marrë në pyetje dhe provë dëshmitarët; dhe
- (5) të drejtë të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve dhe të atyre që mund të sqarojnë faktet.
3. Të ngarkuarit që nuk e njeh ose flet gjuhën e ecurisë i mundësohet falas ndihma e përkthyesit.

### **Neni 29. Ndalimi i dëshmive të paligjshme**

1. Askush nuk mund:

- (1) të shpallet fajtor sipas të dhënave të mbledhura paligjshëm;
- (2) të shtrëngohet me dëshmu kundër vetvetes ose më të afërmeve;
- (3) të shtrëngohet me pranë fajësinë; ose
- (4) të detyrohet me dëshmu pafajësinë.

2. Çdonjëri që ngarkohet me shkelje të ndëshkueshme merret për i pafajshëm deri kur të dëshmohet fajtor sipas ligjit.

### **Neni 30. Ndalimi i stërgjykimit**

Askush nuk mund të gjykohet ose ndëshkohet dy herë nën tagrin e Dardanisë për të njëjtën shkelje, përveç kur një gjykatë më e lartë urdhëron rigjykimin e çështjes.

### **Neni 31. Ndalimi i ndëshkimit të padrejtë**

1. Askush nuk mund të shpallet fajtor ose të ndëshkohet për shkak të një veprimi ose mosveprimi që, në kohën kur u krye, nuk përbënte shkelje të ndëshkueshme me ligj. As të ndëshkohet me dënim më të rëndë se ç'parashihej në kohën kur u krye shkelja ose se ç'parashihet në kohën e dënimit.
2. Ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në shpërpjesëtim me rëndesën e shkeljes.

### **Neni 32. Qasja në drejtësi**

1. Çdonjëri ka të drejtë të kërkojë para gjykatës zhdëmtim të efektshëm kur i cenohet një e drejtë ligjore.
2. Çdonjëri ka të drejtë të ankohet ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj përcaktohet ndryshe.

### **Neni 33. Ndihma juridike**

1. Mbrojtësi dhe ndihma juridike i mundësohen falas çdonjërit që nuk ka mjete të mjaftueshme me pagu, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për qasje të efektshme në drejtësi.
2. Mbrojtësit dhe ndihmësit juridikë janë profesionistë që përmbushin kushtet e përcaktuara me ligj dhe kryejnë shërbime pavarurazi sipas ligjit.

### **Neni 34. Të drejtat e viktimës**

Çdonjëri që, sipas ligjit, është viktimë e një shkeljeje të ndëshkueshme ka të drejtë:

- (1) me qenë i mbrojtur përmes masave të duhura ndaj të ngarkuarit;
- (2) me u njoftu rreth rastit dhe për ikjen ose lirimit e të ngarkuarit;

- (3) me marrë pjesë në ecurinë ligjore ndaj të ngarkuarit; dhe
- (4) me kërku dëmshpërblim nga i ngarkuari.

## **PJESA 4. TË DREJTAT MBI TRUALLIN**

### **Neni 35. Shtetësia**

1. Çdonjëri i lindur në Dardani ose që ka prind a gjysh dardan është vetvetiu qytetar dardan.
2. Qytetar dardan mund të bëhet çdonjëri që, sipas aftësive të veta, njih kënaqshëm gjuhën shtetërore, dhe përmbush kushtet e përcaktuara me ligj.
3. Asnjë qytetari nuk mund t'i mohohet ose t'i hiqet e drejta e shtetësisë.
4. Qytetari dardan ka të drejtë të mbajë njëkohësisht shtetësinë e një shteti tjetër. Por ka detyrë ta bëjë të ditur shtetësinë e huaj sa herë që kandidohet për t'u zgjedhë ose emëruar në detyrë zyrtare.

### **Neni 36. Mbrojtja e qytetarëve**

1. Asnjë qytetar nuk mund të pengohet me hy në Dardani ose të dëbohet a t'i dorëzohet, kundër vullnetit të tij, një shteti të huaj.
2. Shteti mbron me ligj interesat e qytetarëve jashtë vendit.

### **Neni 37. E drejta e lëvizjes**

1. Qytetarët dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Dardanisë kanë të drejtë të lëvizin lirisht brenda Dardanisë dhe të zgjedhin vendbanimin.
2. Çdonjëri ka të drejtë të largohet nga Dardani.

### **Neni 38. Të huajt**

1. Kanë të drejtën e ndorjes në Dardani të huajt të cilët, në vendet e prejardhjes, rrezikohen nga përndjekja për shkak të gjinisë, racës, fesë, kombësisë, mendimit politik, ose bashkësisë shoqërore.
2. Një i huaj nuk mund t'i dorëzohet, kundër vullnetit të tij, një shteti tjetër, nëse i huaji rrezikon:
  - (1) të ndëshkohet për një vepër ose mosvepër që nuk përbën shkelje të ndëshkueshme sipas ligjeve të Dardanisë;
  - (2) të vuajë dënim më të rëndë nga ç'parashohin ligjet e Dardanisë; ose
  - (3) t'i nënshtrohet një ecurie ligjore ose dënimi që është në kundërshtim me të drejtat themelore të mbrojtura me këtë Kushtetutë.
3. Me ligj rregullohet e drejta e të huajve me hy dhe qëndru në Dardani.

## **PJESA 5. LIRITË QYTETARE**

### **Neni 39. Liria e zhvillimit**

Çdonjëri ka të drejtën e lirisë për të zhvilluar shëndetin, shqisën, dhe mendjen dhe për të kërkuar lumturinë vetë dhe si pjesëtar i shoqërisë. Kjo e drejtë përfshin të drejtën për të përfituar nga të mirat e artit, shkencës, teknologjisë, dhe përparimit të gjithëmbarshtëm njerëzor.

**Neni 40. Liria shpirtërore**

1. Çdonjëri ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes, besimit, dhe fesë. Çdonjëri ka të drejtë me pranë, shfaqë, fshehtë, ose ndryshu bindjet, besimin, ose fenë.
2. Ndalohet çdo përpjekje me ushtru autoritet politik ose gjyqësor në emër të fesë.

**Neni 41. Bashkësitë fetare**

1. Shteti mbron vetëqeverisjen e bashkësive fetare dhe monumentet fetare.
2. Bashkësitë fetare janë të lira që të rregullojnë pavarësisht organizimin e vet të brendshëm dhe veprimtaritë fetare, përfshi ritet.
3. Bashkësitë fetare kanë të drejtë të themelojnë shkolla fetare dhe ngrehime bamirëse.

**Neni 42. Liria e shprehjes dhe njoftimit**

1. Çdonjëri ka të drejtën e lirisë së shprehjes, njoftimit, botimit, dhe kumtimit.
2. Çdonjëri ka të drejtë të korrigjojë botimin e pasaktë që ia cenon të drejtat a interesat.
3. Çdonjëri ka të drejtë t'i qasë dokumentet që mbajnë organet shtetërore dhe ngrehimet botore.

**Neni 43. Liria e medias**

1. Mbrohet liria dhe shumësia e mediave.
2. Censura është e ndaluar.
3. Mediat botore janë profesioniste, të pavarura, dhe të paanshme, dhe rregullohen me ligj. Ato mund të përfitojnë nga buxheti shtetëror vetëm për aq sa veprojnë në pajtim me këtë nen.

**Neni 44. Liria e tubimit dhe shoqërimit**

1. Çdonjëri ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të shoqërimit me tjerët. Kjo e drejtë përfshin të drejtën me themel një shoqatë pa pasë nevojë me siguru leje, me qenë ose jo anëtar i një shoqate, dhe me marrë pjesë në veprimtaritë e një shoqate.
2. E drejta me organizu në bashkime punonjësish për t'i mbrojtë interesat vetjake mund të kufizohet me ligj për kategori të veçanta punonjësish për aq sa kufizimi është i domosdoshëm për t'i siguruar shoqërisë shërbimet e domosdoshme.

**PJESA 6. TË DREJTAT E DEMOKRACISË****Neni 45. Të drejtat zgjedhore**

1. Çdo qytetar që ka mbushë moshën 18-vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka detyrë me hedhë votën e vet dhe të drejtë të zgjedhë ose të zgjedhet përfaqësues, përveçse kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor ose Kushtetuta përcakton ndryshe.
2. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë, dhe e fshehtë.

**Neni 46. Barazia gjinore**

1. Pjesëtarët e njëres gjini duhet të përbëjnë, për aq sa është e mundshme, të paktën një të tretën e anëtarëve të çdo organi shumanëtarësh të shtetit.

2. Zgjedhja që bëjnë qytetarët mund të shpërfilllet vetëm për atë që e domosdoshme që pjesëtarët e njëres gjini të përbëjnë një të tretën e anëtarëve të një organi shumëantaresh.

#### **Neni 47. Veprimi qytetar**

1. Çdo qytetar ka të drejtë t'u parashtrijë kërkesë autoriteteve botore dhe të ndikojë demokratikisht në vendimmarrje.
2. Askush nuk mund të përdorë detyrën botore me qëllim që t'i shërbejë drejtpërdrejt interesit vetjak ose të më të afërmeve.

### **PJESA 7. FAMILJA**

#### **Neni 48. Mbrojtja e familjes**

1. Familja përbën gurthemelin e shoqërisë dhe gëzon mbrojtjen e veçantë të shtetit.
2. Çdo prind ka të drejtën e pushimit të lehonisë me pagesë, para dhe pas lindjes së fëmijës.
3. Shteti nxit shtimin e popullsisë dhe ndihmon çdo prind në nevojë me i rritë dhe edukon fëmijët.

#### **Neni 49. Martesa**

1. Dy veta të moshës martesore që nuk janë në lidhje të ngushtë gjaku ose tambli kanë të drejtë që, me pëlqim të lirë dhe në përputhje me ligj, të martohen dhe të krijojnë familje.
2. Martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj dhe mbështetet në barazinë e bashkëshortëve.

#### **Neni 50. Fëmijët**

1. Çdo fëmijë ka hak kujdesin për mirëqenien e tij dhe të mbrojtjes nga dhuna, keqtrajtimi, dhe shfrytëzimi.
2. Të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën duhet të jenë në interesin më të mirë të fëmijës.
3. Çdo fëmijë ka të drejtë të mbajë kumtime të rregullta vetjake dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit dhe gjyshërit e vet, përveçse kur organi përgjegjës kufizon kumtimet ose kontaktet e tilla.

#### **Neni 51. Prindërit**

1. Çdonjëri i moshës madhore ka detyrë të kujdeset për prindin a vjehrrin e vet të moshuar a të paaftë.
2. Çdonjëri që kujdesin parësor ndaj prindit a vjehrrit ia lë në dorë shtetit ka detyrë të mbulojë shpenzimet e kujdesit.

### **PJESA 8. JETESA E NDERSHME**

#### **Neni 52. E drejta e pronës**

1. Çdonjëri ka të drejtë ta gëzojë paqësisht pronën e vet. Kjo e drejtë përfshin të drejtën me bartë pronësinë përmes shitblerjes, dhurimit, ose trashëgimisë.
2. Shteti mund t'i marrë pronën njërit vetëm:

(1) sipas ligjit;

- (2) për përdorim botor;
  - (3) kur shpronësimi është i domosdoshëm për arritjen e një qëllimi botor; dhe
  - (4) pasi t'i ketë paguar pronarit vleftën që prona ka në treg ditën që shpallet shpronësimi.
3. Pronari mund ta rikthejë pronën që i është marrë për të përmbushë detyrime ligjore, duke i përmbushë në plotni detyrimet në çdo kohë para se pronën ta blejë në mirëbesim një palë e tretë.
4. Detyruesi nuk mund të shkakojë ofertën e të detyruarit për të përmbushë detyrimet në plotni ose sipas kontratës.

### **Neni 53. E drejta e plangut**

1. Çdonjëri ka të drejtë të shfrytëzojë plangun.
2. Plangu përbën, deri në madhësinë ose vlerën e arsyeshme, pronën që pronari, bashkëshorti, prindërit, ose fëmijët e mitur të pronarit e përdorin për banim ose për bujqësi mbijetese.
3. Askujt nuk mund t'i merret plangu ose t'i detyrohet shitja e plangut, përveçse:
  - (1) në rast shpronësimi në përputhje me paragrafin 52.2;
  - (2) për të larë huanë e dhënë për blerjen e plangut;
  - (3) për të përmbushë detyrimet për punime të kryera në plang;
  - (4) për të përmbushë detyrimet tatimore;
  - (5) për të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga një barrë e vendosur mbi pronën para bartjes së pronësisë;
  - (6) për të mbuluar shpenzimet e nevojshme për kujdesin ndaj fëmijës së pronarit, nëse fëmija nuk jeton me pronarin; ose
  - (7) për të mbuluar shpenzimet e nevojshme për kujdesin ndaj prindit të moshuar a të paaftë të pronarit, nëse pronari ia ka besuar shtetit kujdesin parësor për prindin.
4. Në rast të një mosmarrëveshjeje lidhur me cilësimin e plangut, pala që kërkon ta marrë pronën ose ta detyrojë shitjen e pronës ka barrën për të dëshmuar se prona nuk cilësohet si plang.
5. Të ardhurat nga shitja e plangut mbrohen, për të paktën një vit, në të njëjtën mënyrë si plangu.

### **Neni 54. E drejta e punës**

1. Çdonjëri ka të drejtë me punu, duke zgjedhë dhe ushtruar lirshëm zanatin dhe duke zgjedhë vendin e punës.
2. Çdonjëri ka të drejtën e lirisë së punës mendore, që përfshin punën akademike, hulumtimin shkencor, shpikjet dhe risimet, si dhe krijimitarinë artistike, letrare, dhe shkencore.
3. Mbrohet prona mendore.

### **Neni 55. E drejta për grevë**

1. Punonjësit kanë të drejtën për grevë që ka të bëjë me marrëdhëniet e punës.
2. E drejta për grevë mund të kufizohet me ligj për kategori të veçanta punonjësish për t'i siguruar shoqërisë shërbimet e domosdoshme.

**Neni 56. Mbrojtja shoqërore**

1. Çdonjëri ka të drejtën e ndihmës së shoqërisë, në pajtim me ligj, për të siguruar, sipas aftësive të veta, një jetesë të denjë dhe të ndershme.
2. Rregullohet me ligj kujdesi shëndetësor dhe sigurimi shoqëror themelor për rastet e papunësisë, sëmundjes, aftësisë së kufizuar, dhe moshës së shtyrë.
3. Të zënë me punë kanë të drejtë të gëzojnë kushte të denja dhe të sigurta për punë, të cilat përfshijnë orarin e arsyeshëm dhe pushimin vjetor të paguar.

**Neni 57. E drejta e arsimimit**

1. Çdonjëri ka të drejtë dhe detyrë të ndjekë shkollimin themelor dhe shkollimin ose aftësimin shtesë të përcaktuar me ligj.
2. Ngrahimet arsimore sigurojnë për çdonjërin mundësi të barabarta për t'u arsimuar sipas aftësive dhe mbëhivë të veta të posaçme.
3. Shteti u jep ndihmën e nevojshme financiare qytetarëve dhe pjesëtarëve të Kombit Shqiptar që nuk kanë mjete të mjaftueshme për t'i mbuluar shpenzimet e shkollimit në ngrehimet botore.

**Neni 58. Mjedisi jetësor**

1. Çdonjëri është përgjegjës për natyrën, gjithllojshmërinë e gjallesave, dhe trashëgiminë kombëtare e kulturore.
2. Gjatë marrjes së një vendimi, organet shtetërore kanë parasysh ndikimin që vendimi mund të ketë në mjedisin jetësor.

**PJESA 9. TË DREJTAT E KOMBËSIVE****Neni 59. Përcaktimi**

1. Kombësitë janë bashkësi kombëtare, gjuhësore, ose fetare, trashëgimisht të pranishme në Dardani.
2. Të drejtat e kombësive u përkasin njëlloj kombësive në tërësi dhe pjesëtarëve të tyre veç e veç.
3. Çdonjëri ka të drejtë të zgjedhë lirisht nëse do të trajtohet ose të mos trajtohet si pjesëtar i një kombësie.

**Neni 60. Roli i shtetit**

1. Shteti mbron dhe ndihmon kombësitë të ruajnë dhe zhvillojnë vetëvetësinë, gjuhën, dhe kulturën e tyre.
2. Shteti nxit dhe ruan tolerancën e bashkëjetesën mes pjesëtarëve të kombësive të ndryshme.
3. Zbatohen drejtëpërsdrejti Konventa Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave.

**Neni 61. Të drejtat simbolike dhe gjuhësore**

1. Kombësitë kanë të drejtë që, sipas ligjit:

- (1) të shfaqin simbolet e tyre;
  - (2) të përfaqësohen në emërtime topografike në rrethet ku banojnë; dhe
  - (3) të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre.
2. Mediat botore duhet të transmetojnë program ose të botojnë përmbajtje të mjaftueshme në gjuhët e kombësive.

#### **Neni 62. Të drejtat arsimore**

1. Pjesëtarët e kombësive kanë të drejtë të ndjekin falas shkollimin parafillor, fillor, dhe të mesëm në gjuhët e tyre.
2. Numri i nxënësve që kërkohet me ligj për themelimin e klasave dhe shkollave nuk mund të paragjykojë pakicat.
3. Shteti mundëson arsimin e lartë në gjuhët shqipe dhe sërbe.

#### **Neni 63. Përfaqësimi dhe punësimi**

1. Kombësitë dhe pjesëtarët e tyre kanë hak përfaqësimin e barabartë në punësim në të gjitha organet shtetërore dhe ngrahimet e ndërmarrjet botore.
2. Përbërja e organeve shtetërore që veprojnë brenda një hapësire tokësore të caktuar duhet të pasqyrojnë për aq sa është e mundshme praninë e kombësive në atë hapësirë.

## **KREU III. PRIJETARI**

---

### **PJESA 1. PËRCAKTIMI DHE TAGRI**

#### **Neni 64. Përcaktimi**

1. Prijetari është kreu i shtetit dhe përfaqëson njëshmërinë e popullit.
2. Prijetari mbron mbarëvajtjen demokratike dhe të kushtetutshme të organeve shtetërore si dhe përfaqëson shtetin brenda dhe jashtë.

#### **Neni 65. Tagri**

Prijetari ka tagër:

- (1) të nxjerrë dekrete;
- (2) të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtare;
- (3) të pranojë letrat kredenciale të krerëve të shpurave të huaja diplomatike;
- (4) të vendojë për dërgimin e shpurave diplomatike e konsullare të Dardanisë dhe të emërojë e shkarkojë krerët e tyre;
- (5) të japë, sipas ligjit, medalje, mirënjohje, dhe çmime;

- (6) të shpallë falje individuale, sipas ligjit;
- (7) t'i drejtohet, së paku një herë në vit, Kuvendit rreth gjendjes së vendit dhe veprimtarisë së Prijetarit; si dhe
- (8) të bartë përgjegjësi tjera të caktuara me Kushtetutë dhe ligj.

## **PJESA 2. ZGJEDHJA**

### **Neni 66. Përcaktimi**

1. Qytetarët me të drejtë vote e zgjedhin Prijetarin në zgjedhje të përgjithshme e të drejtpërdrejta.
2. Zgjedhjet e rregullta mbahen të dielën e dytë të majit, vitin që i mbaron mandati Prijetarit.

### **Neni 67. Cilësimi**

1. Mund të zgjedhet Prijetar çdo qytetar dardan që, ditën që zgjedhet:
  - (1) ka mbushë moshën 40 vjeçare;
  - (2) është i martuar ose i ve;
  - (3) ka fëmijë; dhe
  - (4) në tri vitet e fundit, nuk është përfshi në parti ose veprimtari politike.
2. Mund të kandidohet për Prijetar çdo qytetar që përmbush kushtet për t'u zgjedhë dhe ka përkrahjen e tremijë qytetarëve.
3. I njëjti qytetar nuk mund të rizgjedhet Prijetar më shumë se dy herë.
4. Nuk mund të kandidohet në zgjedhjet e radhës qytetari që sapo është shkarkuar ose ka dhënë dorëheqje nga detyra e Prijetarit.

### **Neni 68. Votimi i parë**

1. Votuesit mund ta miratojnë, kundërshtojnë, ose shpërfillin secilin kandidat veç e veç.
2. Për çdo herë që miratohet, kandidati merr një pikë, dhe për çdo herë që kundërshtohet, kandidatit i hiqet një pikë.
3. Quhet i zgjedhur Prijetar kandidati që ka gjithsej më së shumti pikë dhe miratohet nga mbi gjysma e të gjithë votuesve.

### **Neni 69. Dytësimi**

1. Nëse asnjë kandidat nuk zgjedhet Prijetar, mbahet votimi dytësues të dielën e dytë pas votimit të parë.
2. Në votimin dytësues, votuesit zgjedhin njërin nga dy kandidatët me më së shumti pikë në zgjedhjet e përgjithshme.
3. Quhet i zgjedhur Prijetar kandidati që merr shumicën e votave të vlefshme.

### **PJESA 3. MANDATI**

#### **Neni 70. Fillimi dhe afati**

1. I zgjedhuri Prijetar pranon detyrën e Prijetarit tri javë pas ditës që mbahet rrethi i parë i votimit.
2. Mandati i Prijetarit fillon ditën që Prijetari bën betimin, por jo më vonë se shtatë ditë pas ditës që vërtetohet zgjedhja.
3. Mandati i Prijetarit zgjat jo më shumë se katër vjet, përveç nëse Kushtetuta parasheh ndryshe.

#### **Neni 71. Zbrazëtia**

1. Zyra e Prijetarit lihet zbrazët nëse:

- (1) i zgjedhuri Prijetar nuk bën betimin; ose
- (2) Prijetari shkarkohet, jep dorëheqje, ose vdes.

2. Nëse zyra e Prijetarit lihet zbrazët, ushtrues-detyre Prijetari shpall zgjedhje të parakohshme, të cilat mbahen brenda 60 ditëve pas ditës që lihet zbrazët zyra e Prijetarit.

#### **Neni 72. Papajtueshmëria**

Prijetari nuk mund të ushtrojë asnjë detyrë tjetër botore dhe as të jetë anëtar i një partie politike.

#### **Neni 73. Shlirime**

Prijetari lirohet nga ndjekja për shkelje të ndëshkueshme, paditë qytetare, ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet që merr brenda fushëveprimit të Prijetarit.

### **PJESA 4. MUNGESA DHE SHKARKIMI**

#### **Neni 74. Ushtrues-detyre Prijetari**

1. Kryetari i Kuvendit është ushtrues-detyre Prijetari për aq kohë sa Prijetari të jetë i paaftë me i përmbushë përgjegjësitë e veta ose kur zyra e Prijetarit lihet zbrazët. Por i njëjti qytetar nuk mund të jetë ushtrues-detyre Prijetari për më gjatë se gjatë muaj rresht.
2. Ushtrues-detyre Prijetari merr përgjegjësitë nëse Prijetari ia jep vetë ato ose Kuvendi vlerëson me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve se Prijetari është përkohësisht i paaftë me i përmbushë përgjegjësitë e veta. Prijetari rimerr përgjegjësitë atëherë kur të jetë i aftë me i përmbushë ato.

#### **Neni 75. Shkarkimi**

1. Prijetari mund të shkarkohet nëse:

- (1) është dënuar për kryerjen e një krimi të rëndë;
- (2) nuk është ose nuk do të jetë në gjendje t'i përmbushë përgjegjësitë e veta për shkak të sëmundjes së rëndë që zgjat më shumë se gjashtë muaj; ose
- (3) ka shkelë rëndë Kushtetutën.

**Neni 76. Ecuria e shkarkimit**

1. Një e treta e të gjithë ligjvënësve i paraqesin Kuvendit kërkesën për ta shkarkuar Prijetarin. Kërkesa bëhet me shkrim dhe cek arsytet për ta shkarkuar Prijetarin.
2. Nëse kërkesa cek sëmundjen si arsye për shkarkim, Kuvendi kërkon mendimin e këshillit mjekësor për gjendjen shëndetësore të Prijetarit.
3. Nëse kërkesa pandeh se Prijetari ka shkelë rëndë Kushtetutën, Kuvendi kërkon mendimin e Gjykatës Kushtetutore. Gjykata Kushtetutore ia dorëzon mendimin e saj Kuvendit brenda 14 ditëve vijuese.
4. Kuvendi shqyrton mendimin që ka kërkuar dhe, me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve, shkarkon Prijetarin.

## **KREU IV. KUVENDI**

---

### **PJESA 1. PËRCAKTIMI DHE TAGRI**

**Neni 77. Përcaktimi**

1. Kuvendi ushtron pushtetin ligjvënës.
2. Kuvendi ka 60 ligjvënës.
3. Mund të zgjedhen deri në 10 ligjvënës shtesë, por jo më shumë se ç'është e domosdoshme, për të siguruar përfaqësimin e kënaqshëm të bashkësive të nënpërfaqësuara.

**Neni 78. Tagri**

Kuvendi ka tagër:

- (1) të miratojë ligje, rezoluta, dhe akte të tjera të përgjithshme;
- (2) të miratojë buxhetin shtetëror;
- (3) të mbikëqyrë politikën e jashtme dhe të sigurisë; dhe
- (4) të kryejë detyra tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj.

### **PJESA 2. ZGJEDHJA**

**Neni 79. Përcaktimi**

1. Zgjedhjet për Kuvendin mbahen të dielën e dytë të majit, vitin që mbaron mandati i ligjvënësve.
2. Nëse zgjedhjet për Kuvendin bien të njëjtin vit me zgjedhjet për Prijetar, atëherë zgjedhjet për Kuvendin mbahet një vit më herët.
3. Në raste të parapara me Kushtetutë, Prijetari shpall zgjedhje të parakohshme ose jashtëzakonshme, të cilat mund të mbahet në cilindo vit.

**Neni 80. Cilësimi**

1. Mund të zgjedhet ligjvënës vetëm qytetari që ka mbushë moshën 25-vjeç.
2. Kryebashkiakët dhe zyrtarët e tjerë të cilët mbajnë përgjegjësi përmbarimore në shkallë bashkie nuk mund të zgjedhen pa heqë dorë paraprakisht nga detyra e tyre.
3. Nuk mund të kandidohen ose të zgjedhen pa heqë dorë paraprakisht nga detyra e tyre zyrtarët shtetërorë të cilëve u ndalohet me ligj përfshirja në veprimtari politike.
4. Nuk mund të kandidohen ata të cilëve, me vendim përfundimtar të gjykatës, u është heqë zotësia juridike për të vepruar.

**Neni 81. Viset zgjedhore**

1. Me ligj, trualli i Dardanisë ndahet në 20 vise zgjedhore me popullsi të barabartë, por duke i marrë parasysh vijat e njërive të mbarështimit dhe ndarjet e natyrshme mes trevave, bashkive, dhe vendbanimeve.
2. Banorët me të drejtë vote të secilit vis zgjedhin nga tre ligjvënës.
3. Qytetarët që banojnë jashtë vendit mund të votojnë si banorë të visit ku janë lindë, kanë banuar, ose kanë lidhje të dëshmuara të përcaktuara me ligj.

**PJESA 3. MANDATI****Neni 82. Përcaktimi**

Ligjvënësit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues.

**Neni 83. Afati**

1. Mandati i të gjithë anëtarëve fillon ditën që vërtetohen zgjedhjet dhe mbaron 30 ditë para ditës së zgjedhjeve të përgjithshme.
2. Mandati zgjat jo më shumë se katër vjet, përveç nëse Kushtetuta parasheh ndryshe.

**Neni 84. Mbarimi i parakohshëm**

1. Mandati mbaron para kohe ose bëhet i pavlefshëm nëse ligjvënësi:

- (1) nuk bën betimin;
  - (2) jep dorëheqje;
  - (3) emërohet anëtar i Kabinetit;
  - (4) mungon gjashtë muaj rresht nga mbledhjet e Kuvendit, përveç rasteve të veçanta, në të cilat dhoma mund të vendosë ndryshe;
  - (5) shpallet fajtor për shkelje të ndëshkueshme dhe me vendim të prerë gjyqësor dënohet me një ose më shumë vjet burgim; ose
  - (6) vdes.
2. Nëse mandati i një ligjvënësi mbaron para kohe, vendi i tij plotësohet sipas ligjit.

**Neni 85. Papajtueshmëria**

Ligjvënësi nuk mund të mbajë ndonjë post përmbarimor në mbarështimin botor ose në ndonjë ndërmarrje në pronësi botore dhe as të ushtrojë ndonjë detyrë tjetër përmbarimor që mund t'i ndalohej me ligj.

**Neni 86. Shlirime**

1. Ligjvënësi lirohet nga ndjekja ndëshkimore, paditë qytetare, dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet që merr brenda fushëveprimit të ligjvënësit.
2. Ligjvënësi nuk mund të ndalohej ose burgohet pa pëlqimin e shumicës së të gjithë ligjvënësve përderisa është duke kryer detyrat e veta si ligjvënës.

**PJESA 4. RREGULLIMI I BRENDSHËM****Neni 87. Rregullorja e punës**

1. Kuvendi miraton me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve rregulloren e punës.
2. Rregullorja e punës përcakton organizimin e brendshëm dhe punën e Kuvendit, ligjvënësve, kryesisë, togjeve të ligjvënësve, dhe komisioneve.

**Neni 88. Kryesia**

1. Kuvendi zgjedh dhe shkarkon, nga radhët e të paktën tri togjeve më të mëdha të ligjvënësve dhe me shumicën e të gjithë ligjvënësve, kryesinë e përbërë nga kryetari dhe tre nënkryetarë.
2. Anëtarët e kryesisë shkarkohen me praninë e të paktën dy të tretave të të gjithë ligjvënësve.

**Neni 89. Mbledhjet**

1. Mbledhjet e Kuvendit janë të hapura.
2. Mund të kërkojnë mbledhje të mbyllur Prijetari, Kryeministri, ose një e treta e të gjithë ligjvënësve. Kuvendi miraton kërkesën hapur me dy të tretat e ligjvënësve të pranishëm.

**Neni 90. Orari**

1. Kuvendi mbledhet të paktën dy herë në vit: të hënën e tretë të janarit dhe të hënën e dytë të shtatorit.
2. Mbledhje e jashtëzakonshme mbahet me kërkesë të Prijetarit, të Kryeministrit, ose të një të tretës së ligjvënësve.

**Neni 91. Punimet**

1. Punimet e Kuvendit nuk mund të zhvillohen pa praninë e të paktën gjysmës së ligjvënësve.
2. Ligjvënësit votojnë hapur për çdo vendim që merr Kuvendi.

**Neni 92. Komisionet**

1. Kuvendi ngrit nga radhët e veta komisione për punë të posaçme.
2. Një e treta e të gjithë ligjvënësve detyrojnë Kuvendin të ngritë komision hetimor.

## PJESA 5. ECURIA LIGJVËNËSE

### Neni 93. Nisma ligjvënëse

Mund t'i parashtrojnë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim një projektligj 10 mijë qytetarë me të drejtë vote, cilido ligjvënës, Prijetari, ose Kabineti.

### Neni 94. Miratimi

1. Projektligji votohet tri herë: në parim, nen për nen, dhe në tërësi.
2. Kuvendi mund të vendosë, me kërkesë të Kabinetit ose të një së pestës së të gjithë ligjvënësve, ta shqyrtojë dhe miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar. Kuvendi vendos për procedurën e përshpejtuar brenda shtatë ditëve para ditës që fillon shqyrtimi i projektligjit.
3. Procedura e përshpejtuar nuk lejohet për projektligjet që duhet të miratohen me shumicë të cilësuar, me përjashtim të projektligjeve për masat e jashtëzakonshme.

### Neni 95. Shpallja

1. Pasi ta miratojë ligjin, Kuvendi ia paraqet atë menjëherë Prijetarit.
2. Brenda ditës ose shtatë ditëve vijuese, Prijetari shpall ose kthen ligjin në Kuvend për rishqyrtim dhe cek pse po e kthen.
3. Nëse Prijetari nuk e shpall ose kthen ligjin, ligji vetëshpallet shtatë ditë pas ditës që i paraqitet Prijetarit.
4. Nëse Prijetari e kthen ligjin, Kuvendi mund ta rimiratojë dhe ta shpallë vetë ligjin pa e ndryshuar vetëm me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve.

### Neni 96. Hyrja në fuqi

1. Ligji hyn në fuqi vetëm pasi të shpallet dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
2. Ligji botohet jo më vonë se 14 ditë pas ditës që shpallet dhe hyn në fuqi 14 ditë pas ditës që botohet, përveç nëse vetë ligji përcakton ndryshe.

## PJESA 6. VENDIME TË POSAÇME

### Neni 97. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

1. Kuvendi miraton me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve marrëveshjet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me:

- (1) truallin, paqen, aleancat, dhe çështjet politike e ushtarake;
- (2) të drejtat themelore;
- (3) anëtarësimin në organizata ndërshtetërore; dhe
- (4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare.

2. Miratohet në Kuvend çdo marrëveshje ndërkombëtare që ka të bëjë me miratimin, ndryshimin, plotësimin, ose shfuqizimin e ligjeve.

**Neni 98. Kushtetutshmëria e marrëveshjeve ndërkombëtare**

1. Prijetari ose një e pesta e të gjithë ligjvënësve mund t'i kërkojnë Gjykatës Kushtetutore të shqyrtojë kushtetutshmërinë e një marrëveshjeje ndërkombëtare para se marrëveshja të ratifikohet.
2. Ditën që i bëhet kërkesa ose gjatë 30 ditëve vijuese, Gjykata Kushtetutore parandalon ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare që nuk është në pajtim me Kushtetutën.
3. Nuk mund të ratifikohet një marrëveshje ndërkombëtare të cilën është duke e shqyrtuar Gjykata Kushtetutore.

**Neni 99. Ligje të posaçme**

1. Kuvendi miraton me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve ligjet për:

- (1) simbolet kombëtare dhe shtetërore;
- (2) liritë fetare dhe marrëveshjet me bashkësitë fetare; dhe
- (3) festat botore.

2. Kuvendi miraton me tri të pestat e të gjithë ligjvënësve ligjet për:

- (1) organet dhe autoritetet posaçërisht të cekura në Kushtetutë;
- (2) ndarjet mbarështimore të truallit të shtetit;
- (3) bashkitë, përfshi themelimin, shuarjen, kufijtë, dhe pushtetet e tyre;
- (4) shtetësinë;
- (5) zgjedhjet dhe referendumet;
- (6) masat e jashtëzakonshme;
- (7) zyrtarët botorë;
- (8) amnistinë; dhe
- (9) arsimin.

**Neni 100. Kërkesa për shpërndarje**

Dy të tretat e të gjithë ligjvënësve mund t'i kërkojnë Prijetarit ta shpërndajë Kuvendin dhe të shpallë zgjedhje të parakohshme për Kuvendin.

---

**KREU V. KABINETI**

---

**PJESA 1. PËRCAKTIMI DHE TAGRI****Neni 101. Përcaktimi**

1. Pushtetin përmbartimor e ushtron Kabineti.
2. Kabinetin e përbëjnë Kryeministri, Zëvendëskryeministri, dhe jo më shumë se dhjetë ministra.

**Neni 102. Tagri i Kabinetit**

Kabineti ka tagër:

- (1) të zbatojë ligjet dhe aktet tjera të miratuara nga Kuvendi;
- (2) të paraqesë dhe të zbatojë politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit;
- (3) të mundësojë zhvillimin ekonomik të vendit;
- (4) të marrë vendime dhe të nxjerrë akte juridike të nevojshme për zbatimin e ligjeve;
- (5) të paraqesë buxhetin shtetëror;
- (6) të udhëzojë dhe mbikëqyrë punën e organeve të mbarështimit;
- (7) të udhëzojë veprimtarinë dhe zhvillimin e shërbimeve botore;
- (8) të bartë përgjegjësi tjera të parapara me Kushtetutë dhe ligj; dhe
- (9) të bartë përgjegjësi tjera përmbarimore, të cilat nuk u janë caktuar organeve tjera qendrore ose vendore.

**Neni 103. Tagri i Kryeministrit**

Kryeministri ka tagër:

- (1) ta udhëheqë dhe përfaqësojë Kabinetin;
- (2) të sigurojë zbatimin e politikave të Kabinetit;
- (3) të emërojë, me miratimin e Kuvendit, anëtarët e Kabinetit;
- (4) të shkarkojë, pa pëlqimin e Kuvendit, anëtarët e Kabinetit;
- (5) të këshillohet me Prijetarin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit; dhe
- (6) të bartë përgjegjësi tjera të parapara me Kushtetutë dhe ligj.

**PJESA 2. ZGJEDHJA****Neni 104. Mandatimi nga Prijetari**

1. Brenda 14 ditëve pas ditës që mbahet mbledhja e parë e Kuvendit ose ditës që jep dorëheqje Kabineti, Prijetari cakton një mandatar për ta bërë Kabinetin e ri dhe për të shërbyer si Kryeministër.
2. Në caktimin e mandatarit, Prijetari përdor gjykimin e vet dhe nuk është i detyruar ta marrë parasysh përbërjen politike të Kuvendit.

**Neni 105. Miratimi në Kuvend**

1. Brenda 14 ditëve pas ditës në të cilën caktohet, mandataria ia paraqet Kuvendit programin dhe përbërjen e Kabinetit të ri. Pastaj, Kuvendi vendos menjëherë, pa debat, me votim të hapur dhe me shumicën e të gjithë ligjvënësve, nëse do ta miratojë bërjen e Kabinetit të ri.
2. Brenda shtatë ditëve pas ditës së miratimit nga Kuvendi, Kabineti i ri paraqitet para Prijetarit për ta bërë betimin dhe për ta pranuar detyrën.

**Neni 106. Përmbysja e mandatarit**

1. Nëse Kuvendi nuk e miraton bërjen e Kabinetit të ri, ose mandatarin nuk është në gjendje ose nuk pranon ta bëjë Kabinetin e ri, mandatarin quhet i përmbysur.
2. Prijetari cakton një mandatar të dytë brenda shtatë ditëve pas ditës që përmbysset mandatarin i parë. Mandatarin i dytë caktohet në të njëjtën mënyrë dhe ka të njëjtat detyra dhe kushte si mandatarin i parë.

**Neni 107. Mandatimi nga Kuvendi**

1. Nëse Prijetari nuk e cakton mandatarin e dytë brenda afatit, ose përmbysset edhe mandatarin i dytë, të drejtën për ta caktuar mandatarin e merr Kuvendi.
2. Mandatarin që e cakton Kuvendi ka të njëjtat detyra dhe kushte, por mund të mos ketë të njëjtin afat, si një mandatar që e cakton Prijetari.
3. Nëse, brenda 14 ditëve pas ditës që të drejtën për ta caktuar mandatarin e merr Kuvendi, nuk paraqitet një Kabinet i ri para Prijetarit, Prijetari mund ta shpërndajë Kuvendin.

**Neni 108. Ribërja e Kabinetit**

1. Kryeministri ose një e treta e të gjithë ligjvënësve mund t'i kërkojnë Kuvendit të ribëjë Kabinetin. Parashtruesi i kërkesës cakton njëkohësisht një mandatar të ri për ta bërë Kabinetin e ri dhe për të shërbyer si Kryeministër.
2. Brenda shtatë ditëve pas ditës që bëhet kërkesa, mandatarin i ri ia paraqet Kuvendit programin dhe përbërjen e Kabinetit të ri. Pastaj, Kuvendi vendos menjëherë, pa debat, me votim të hapur dhe me shumicë votash të të gjithë ligjvënësve, nëse do të miratojë bërjen e Kabinetit të ri.
3. Kërkesa për ribërjen e Kabinetit nuk mund të përsëritet brenda 90 ditëve.

**Neni 109. Dorëheqja e Kabinetit**

1. Nëse Kuvendi miraton bërjen e Kabinetit të ri, Kabineti paraprak quhet në dorëheqje deri në kohën kur Kabineti i ri ta marrë detyrën.
2. Nëse Kuvendi nuk miraton bërjen e Kabinetit të ri, Kabineti i tashëm mbetet në detyrë.

**PJESA 3. PUNA****Neni 110. Përgjegjësia**

1. Kabineti, për punën e vet, i përgjigjet Kuvendit.
2. Anëtari i Kabinetit mban bashkëpërgjegjësi për vendimet që merr Kabineti, përveç nëse anëtari kundërshton vendimin në kohën që ai merret dhe e dëshmon kundërshtimin.
3. Anëtari i Kabinetit mban përgjegjësi të veçantë për vendimet që merr në fushëveprimin e vet.

**Neni 111. Shlirime**

Anëtari i Kabinetit lirohet nga ndjekja për shkelje të ndëshkueshme, paditë qytetare, dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet që merr brenda fushëveprimit të anëtarit të Kabinetit.

**Neni 112. Rregullimi i brendshëm**

1. Mënyra e punës dhe procedurat e vendimmarrjes në Kabinet përcaktohen me ligj dhe me rregullore.
2. Një këshill i pavarur mbikëqyrës siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin qytetnor.

## KREU VI. GJYQËSIA

---

### PJESA 1. PARIME TË PËRGJITHSHME

**Neni 113. Përcaktimi**

1. Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat e pavarura dhe jopolitike.
2. Gjykatat ndajnë drejtësinë sipas Kushtetutës, ligjeve tjera, dhe vendimeve paraprijëse gjyqësore.
3. Vendimet gjyqësore janë të detyrueshme për të gjitha organet shtetërore.

**Neni 114. Kushtetutshmëria**

1. Gjykatat nuk i zbatojnë ligjet që janë në kundërshtim me Kushtetutën.
2. Gjykatat mund t'i kërkojnë Gjykatës Kushtetutore të shqyrtojë çështje kushtetutore.

**Neni 115. Lëndët gjyqësore**

1. Gjykatat shqyrtojnë vetëm lëndë ose mosmarrëveshje të mirëfillta mes palëve kundërshtare që paraqiten para gjykatës.
2. Një lëndë ose mosmarrëveshje quhet e mirëfilltë kur njëra palë i kërkon gjykatës ta ndalojë një ligj ose veprim që po dëmton ose është gati me dëmtu palën ose kur njëra palë kërkon dëmshpërblim për dëmet që ka pësuar.

**Neni 116. Pagjyqeshmëria**

1. Pos kur Kushtetuta përcakton ndryshe, gjykatat nuk japin mendime këshilluese as nuk shqyrtojnë raste në të cilat vendimi i gjykatës nuk është i plotfuqishëm.
2. Gjykatat nuk shqyrtojnë raste politike, përfshi çështjet që u janë besuar ose mund të zgjidhen më mirë kur u lihen në dorë organeve shtetërore që u nënshtrohen zgjedhjeve të drejtpërdrejta.

### PJESA 2. GJYKATAT

**Neni 117. Gjykatat themelore dhe ankimore**

1. Gjykatat themelore janë gjykata të shkallës së parë.
2. Gjykatat ankimore janë gjykata më të larta, të cilat rishikojnë vendimet e gjykatave të shkallës së parë pas ankimit të njëres palë.

3. Vendimet e një gjykate ankimore janë të detyrueshme për gjykatat e shkallës së parë mbi të cilat ka tagër gjykata ankimore.

#### **Neni 118. Gjykata e Naltë**

1. Gjykata e Naltë është gjykata më e lartë për çështje jokushtetutore në Dardani. Gjykata e Naltë rishikon vendimet e gjykatave ankimore pas lutjes së njëjës palë.
2. Pos rasteve të përcaktuara me ligj, Gjykata e Naltë shqyrton lëndët për shqyrtimin e të cilave japin pëlqimin dy të pestat e gjyqtarëve të Gjykatës së Naltë.
3. Vendimet e Gjykatës së Naltë janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat.

#### **Neni 119. Rregullimi**

1. Ndërtimi, puna, dhe tagri i gjykatave rregullohet me ligj.
2. Një gjykatë e posaçme mund të themelohet me ligj kur themelimi i saj të jetë i nevojshëm.
3. Nuk mund të ketë gjykata të jashtëzakonshme.

### **PJESA 3. GJYQTARËT**

#### **Neni 120. Mandati**

1. Gjyqtarët i emëron, riemëron, dhe shkarkon Këshilli Gjyqësor me pëlqimin e Prijetarit.
2. Gjyqtari shërben fillimisht për tri vjet.
3. Nëse riemërohet, gjyqtari shërben deri në moshën ligjore të pensionimit, përveç nëse shkarkohet.

#### **Neni 121. Pavarësia dhe papajtueshmëria**

1. Gjyqtarët në punën e tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.
2. Gjyqtari nuk mund:
  - (1) të ushtrojë ndonjë detyrë në organet shtetërore jashtë gjyqësisë;
  - (2) të përfshihet në ndonjë veprimtari politike ose ndonjë veprimtari tjetër të ndaluar me ligj; ose
  - (3) të përfshihet në veprim ose sjellje që bie ndesh me pavarësinë, paanësinë, ose denjësinë e gjyqtarit.

#### **Neni 122. Shlirime**

1. Gjyqtari ose gjyqtari porot lirohet nga ndjekja për shkelje të ndëshkueshme, paditë qytetare, dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet që merr brenda fushëveprimit të gjyqtarit.
2. Gjyqtari dhe gjyqtari porot nuk gëzon shirim nëse shkel ligjin qëllimisht.
3. Kur një gjyqtar ngarkohet me shkelje të ndëshkueshme ose ndalohet, organet e rendit njoftojnë pa vonesë Këshillin Gjyqësor.

#### **Neni 123. Bartja**

Gjyqtarët nuk mund të barten kundër vullnetit të tyre, përveçse për mbarëvajtjen e gjyqësorit, për zbatimin e masave disiplinore, ose kur me ligj parashihet ndryshe.

**Neni 124. Shkarkimi**

1. Një gjyqtar mund të shkarkohet nëse:

- (1) dënohet për krim të rëndë;
- (2) shpallet i paaftë mendërisht ose trupërisht; ose
- (3) shpërfill rëndë detyrat e gjyqtarit.

2. Gjyqtari i shkarkuar ka të drejtë të ankohet ndaj shkarkimit drejtpërdrejt në Gjykatën e Naltë.

**PJESA 4. KËSHILLI GJYQËSOR****Neni 125. Përcaktimi dhe tagri**

1. Këshilli Gjyqësor është organ i pavarur dhe i paanshëm, i cili siguron pavarësinë, paanësinë, dhe profesionizmin e gjykatave dhe gjyqtarëve.

2. Këshilli Gjyqësor ka tagër:

- (1) të përzgjedhë, emërojë, dhe riemërojë gjyqtarët;
- (2) të bartë dhe disjplinojë gjyqtarët;
- (3) të përpilojë rregulla sipas ligjit për punën e gjykatave;
- (4) të mbikëqyrë dhe mbarështojë gjykatat;
- (5) të hartojë dhe mbikëqyrë buxhetin e gjykatave;
- (6) përcaktojë numrin e gjyqtarëve të nevojshëm;
- (7) rekomandojë themelimin e gjykatave të reja; dhe
- (8) të njoftojë Kuvendit, të paktën një herë në vit, për gjendjen e gjyqësisë.

**Neni 126. Përbërja**

1. Këshilli Gjyqësor ka 13 anëtarë me cilësime dhe përvojë profesioniste.

2. Gjyqtarët emërojnë pesë dhe Kuvendi tetë anëtarë të Këshillit Gjyqësor. Prej anëtarëve që emëron Kuvendi, dy janë gjyqtarë dhe një avokat.

3. Anëtarët e Këshillit Gjyqësor shërbejnë për pesë vjet.

4. Kushtet për të qenë anëtar i Këshillit Gjyqësor rregullohen me ligj.

**Neni 127. Puna**

1. Këshilli Gjyqësor përzgjedh, emëron, dhe riemëron gjyqtarët përmes një ecurie të hapur dhe sipas meritës dhe kriterëve të përcaktuara me ligj.

2. Kur emëron ose riemëron një gjyqtar të një gjykate, Këshilli Gjyqësor këshillohet me gjykatën.

3. Rregullimi i brendshëm i Këshillit Gjyqësor përcaktohet me ligj.

## KREU VII. GJYKATA KUSHTETUTORE

---

### PJESA 1. PËRCAKTIMI DHE TAGRI

#### Neni 128. Përcaktimi

1. Gjykata Kushtetutore është gjykatë e posaçme përgjegjëse për ndërpreimin përfundimtar të Kushtetutës.
2. Gjykata Kushtetutore ka 12 gjyqtarë kushtetutorë.
3. Pos kur Kushtetuta përcakton ndryshe, shqitjet që vlejné për gjykatat tjera vlejné edhe për Gjykatën Kushtetutore.

#### Neni 129. Tagri

1. Gjykata Kushtetutore rishikon, pas ankimit të njëres palë, vendimet e gjykatave për çështje që burojnë nga Kushtetuta ose marrëveshjet ndërkombëtare.
2. Gjykata Kushtetutore bart përgjegjësi tjera që ia cakton Kushtetuta.
3. Pos kur Kushtetuta përcakton ndryshe, Gjykata Kushtetutore shqyrton çështjet në pajtim me [nenet 115-16](#).
4. Gjykata Kushtetutore ka të drejtë vetëm t'i shfuqizojë ligjet, vendimet, ose veprimet që shqyrton.

### PJESA 2. GJYQTARËT KUSHTETUTORË

#### Neni 130. Emërimi

1. Gjyqtarët kushtetutorë i emëron Prijetari me miratimin e shumicës së të gjithë ligjvënësve në Kuvend.
2. Mund të emërohen gjyqtarë kushtetutorë juristët me cilësim të lartë dhe me përvojë pune jo më pak se 15 vjet.
3. Një e katërta e gjyqtarëve kushtetutorë emërohen çdo katër vjet.
4. Kryetarin dhe nënkryetarin e Gjykatës Kushtetutore e emëron nga radhët e gjyqtarëve kushtetutorë Prijetari me miratimin e shumicës së të gjithë ligjvënësve në Kuvend.

#### Neni 131. Mandati

1. Gjyqtari kushtetutor fillon detyrën pasi të bëjë betimin para Prijetarit.
2. Gjyqtari kushtetutor shërben jo më shumë se 12 vjet, përveç kur nuk emërohet me kohë pasardhësi i tij.
3. I njëjti qytetar nuk mund të riemërohet gjyqtar kushtetutor.
4. Gjyqtari kushtetutor largohet para kohe kur:
  - (1) dënohet me vendim të prerë për shkelje të ndëshkueshme;
  - (2) mungon në detyrë pa arsye për më shumë se gjashtë muaj;
  - (3) mbush moshën 75 vjeç;

(4) jep dorëheqje; ose

(5) shpallet me vendim të prerë gjyqësor i paaftë për të vepruar.

5. Largimin para kohe të gjyqtari kushtetutor e shpall Gjykata Kushtetutore.

6. Nëse një gjyqtar kushtetutor largohet para kohe, Prijetari emëron, me miratimin e shumicës së të gjithë ligjvënësve në Kuvend, një zëvendësues. Zëvendësuesi shërben deri kur do të shërbente gjyqtari kushtetutor i larguar sikur të mos largohet.

### **Neni 132. Pavarësia dhe papajtueshmëria**

1. Gjyqtarët kushtetutorë në punën e tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.

2. Gjyqtari kushtetutor nuk mund:

(1) të ushtrojë ndonjë detyrë në organet shtetërore jashtë gjyqësisë;

(2) të përfshihet në ndonjë veprimtari politike ose ndonjë veprimtari tjetër të ndaluar me ligj; ose

(3) të përfshihet në veprim ose sjellje që bie ndesh me pavarësinë, paanësinë, ose denjësinë e gjyqtarit.

### **Neni 133. Shlirime**

1. Gjyqtari kushtetutor lirohet nga ndjekja për shkelje të ndëshkueshme, paditë qytetare, dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet që merr brenda fushëveprimit të gjyqtarit kushtetutor.

2. Gjyqtari kushtetutor nuk mund të ndalet ose t'i hiqet liria në çfarëdo trajte ose t'i nënshtrohet bastisjes pa miratimin e vetë Gjykatës Kushtetutore, përveçse kur kapet duke kryer ose menjëherë pasi të ketë kryer shkelje të ndëshkueshme.

3. Nëse gjyqtari kushtetutor ndalet pa miratimin e Gjykatës Kushtetutore, Kryepërndjekësi njofton menjëherë Gjykatën Kushtetutore për ndaljen. Nëse Gjykata Kushtetutore nuk e miraton brenda 24 orëve vijuese dërgimin para gjykatës së gjyqtarit kushtetutor të ndalur, gjyqtari lirohet.

### **Neni 134. Shkarkimi**

1. Gjyqtarin kushtetutor mund ta shkarkojë Kuvendi me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve nëse:

(1) dënohet për shkelje të ndëshkueshme;

(2) shpallet i paaftë mendërisht ose trupërisht; ose

(3) shpërfill rëndë detyrat e gjyqtarit.

2. Pasi vendos për ta shkarkuar një gjyqtar kushtetutor, Kuvendi njofton Gjykatën e Naltë. Po atë ditë ose brenda 14 ditëve vijuese, Gjykata e Naltë vërteton ligjshmërinë e shkarkimit të gjyqtarit kushtetutor. Nëse vlerëson se shkarkimi është i ligjshëm, Gjykata e Naltë shpall shkarkimin e gjyqtarit kushtetutor.

## **PJESA 3. PUNA**

### **Neni 135. Rregullimi i brendshëm**

1. Gjykata Kushtetutore përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, ecuritë e vendimmarrjes, dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin.

## 2. Gjykata Kushtetutore boton raportin vjetor.

### Neni 136. Shqyrtimi i lëndëve

1. Pos rasteve të përcaktuara me ligj, Gjykata Kushtetutore shqyrton lëndët për shqyrtimin e të cilave japin pëlqimin dy të pestat e gjyqtarëve kushtetutorë.
2. Një lëndë shqyrtohet nga një pleqësi e përbërë nga jo më shumë se nëntë gjyqtarë kushtetutorë. Pleqësia shqyrtuese caktohet me short në mënyrën që përcakton vetë Gjykata Kushtetutore.
3. Gjykata Kushtetutore vendos për një lëndë me shumicën e të gjithë gjyqtarëve kushtetutorë që shqyrtojnë lëndën.

### Neni 137. Fuqia juridike

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetutore janë të prera dhe të detyrueshme.
2. Vendimi i Gjykatës Kushtetutore hyn në fuqi vetëm pasi të botohet në Fletoren Zyrtare. Vendimi hyn në fuqi ditën që botohet, përveç kur Gjykata Kushtetutore zgjedh një datë më të vonshme.
3. Vendimi i Gjykatës Kushtetutore botohet jo më vonë se 14 ditë pas ditës që botohet, përveç kur Gjykata Kushtetutore vendos ndryshe.
4. Mendimi mospajtues i një gjyqtari kushtetutor botohet bashkë me vendimin e Gjykatës Kushtetutore.

### Neni 138. Vendime të posaçme

1. Gjykata Kushtetutore mund t'i përmbarojë përmes Ushtrisë vendimet në lidhje me paragrafët 7.2 dhe 40.2.
2. Për çështjet e parapara me këtë nen, Gjykata Kushtetutore mund t'i drejtohet Ushtrisë vetëm pasi organet tjera të shtetit të mos jenë në gatishmëri të përmbarojnë vendimet e Gjykatës Kushtetutore.

## **KREU VIII. ORGANE TË POSAÇME**

---

### **PJESA 1. PËRNDJEKËSIT SHTETËRORË**

#### Neni 139. Përcaktimi

1. Përndjekësit shtetërorë janë zyrtarë të pavarur dhe të paanshëm, përgjegjës për ndjekjen e të dyshuarve për shkelje të ndëshkueshme ose shkelje tjetër të përcaktuar me ligj.
2. Tagri dhe puna e brendshme e përndjekësve rregullohet me ligj.

#### Neni 140. Mandati

1. Përndjekësi shërben fillimisht për tri vjet.
2. Nëse riemërohet, përndjekësi shërben deri në moshën ligjore të pensionimit, përveç nëse shkarkohet.

3. Përndjekësi mund të shkarkohet për shkak të dënimit për një krim të rëndë ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave.

#### **Neni 141. Pavarësia dhe papajtueshmëria**

1. Përndjekësit në punën e tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.

2. Përndjekësi nuk mund:

(1) të ushtrojë ndonjë detyrë në organet shtetërore jashtë përndjekësisë;

(2) të përfshihet në ndonjë veprimtari politike ose ndonjë veprimtari tjetër të ndaluar me ligj; ose

(3) të marrë sipër përgjegjësi ose ushtrojë detyrë që bie ndesh me pavarësinë, paanësinë, ose denjësinë e përndjekësit.

#### **Neni 142. Kryepërndjekësi**

1. Kryepërndjekësin shtetëror e emëron dhe shkarkon Prijetari, sipas paraqitjes së Këshillit Përndjekësor.

2. Kryepërndjekësi shërben për shtatë vjet dhe nuk ka të drejtë të riemërohet.

#### **Neni 143. Këshilli Përndjekësor**

1. Këshilli Përndjekësor është organ i pavarur dhe i paanshëm, i cili siguron pavarësinë, paanësinë, dhe profesionizmin e përndjekësve shtetërorë.

2. Këshilli Përndjekësor përzgjedh dhe paraqet kandidatët për përndjekës, përmes një ecurie të hapur dhe duke u mbështetur në meritat e kandidatëve dhe kriteret e përcaktuara me ligj, si dhe bart dhe disiplinon përndjekësit.

3. Përbërja dhe rregullimi i brendshëm e Këshillit Përndjekësor përcaktohen me ligj.

## **PJESA 2. AVOKATI I POPULLIT**

#### **Neni 144. Përcaktimi dhe tagri**

1. Avokati i Popullit është organ i pavarur dhe i paanshëm, i cili mbron të drejtat themelore.

2. Avokati i Popullit ka tagër:

(1) të flasë para Kuvendit kurdoherë që e sheh të vyeshme;

(2) t'i paraqesë Kuvendit raport vjetor dhe, sipas kërkesës, raporte tjera mbi gjendjen e të drejtave themelore;

(3) të rekomandojë masa kur vëren shkelje të të drejtave themelore; dhe

(4) të shtrojë çështje në gjykatë në emër të palëve të dëmtuara.

#### **Neni 145. Emërimi**

1. Avokatin e Popullit e emëron Kuvendi me shumicën e të gjithë ligjvënësve. Avokat i Popullit ka të drejtë të zgjidhet çdo qytetar i ndershëm:

(1) me karakter e moral të lartë;

(2) me arsim të lartë; dhe

(3) me përvojë dhe njohuri të dalluara në fushën e të drejtave të njeriut.

2. I emëruari Avokat i Popullit shërben për pesë vjet dhe nuk mund të riemërohet.

#### **Neni 146. Zëvendësi**

1. Avokati i Popullit ka një ose më shumë zëvendës.

2. Të paktën një zëvendës është pjesëtar i kombësive që nuk janë shumicë në Dardani.

3. Emërimi i zëvendësve rregullohet me ligj.

#### **Neni 147. Puna**

1. Avokati i Popullit nuk pranon udhëzime ose ndërhyrje nga zyrtarët, organet shtetërore, ose autoritetet tjera.

2. Çdo zyrtar, organ shtetëror, ose autoritet tjetër ka detyrë t'i përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'ia paraqesë atij të gjitha dokumentet dhe të dhënat e kërkuara ligjërisht.

3. Avokati i Popullit, sipas ligjit, parashtron dhe mbarështon mëvetësisht buxhetin e vet.

#### **Neni 148. Papajtueshmëria**

1. Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij nuk mund:

(1) të jenë anëtarë të asnjë partie politike;

(2) të ushtrojnë veprimtari politike, shtetërore, ose private profesioniste; ose

(3) të marrin pjesë në organizmat drejtues të organizatave qytetare, ekonomike, dhe tregtare.

#### **Neni 149. Shlirime**

Avokati i Popullit lirohet nga ndjekja për shkelje të ndëshkueshme, paditë qytetare, ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet që merr brenda fushëveprimit të Avokatit të Popullit.

#### **Neni 150. Shkarkimi**

1. Një e treta e të gjithë ligjvënësve mund t'i kërkojnë Kuvendit ta shkarkojë Avokatin e Popullit.

2. Kuvendi shkarkon Avokatin e Popullit me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve.

### **PJESA 3. VËZHguesi I PËRGJITHSHËM**

#### **Neni 151. Përcaktimi dhe tagri**

1. Vëzhguesi i Përgjithshëm është organ i pavarur, i cili mbikëqyr çështjet ekonomike dhe financiare.

2. Vëzhguesi i Përgjithshëm vëzhgon:

(1) veprimtarinë ekonomike të organeve shtetërore dhe ngrehimeve botore;

(2) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve botore;

(3) veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve botore dhe vetave tjerë juridikë, te të cilët shteti ka interes pronësor; dhe

(4) veprimtarinë e kujtdo për detyrimet financiare të të cilit shteti ka hy dorëzanë.

#### **Neni 152. Raportimet**

1. Vëzhguesi i Përgjithshëm i paraqet Kuvendit:

(1) raport vjetor për veprimtarinë e Vëzhguesit të Përgjithshëm;

(2) raport për zbatimin e buxhetit shtetëror;

(3) mendimin për raportin e Kabinetit për shpenzimet e vitit financiar para se Kuvendi ta miratojë raportin;

(4) njoftime për rezultatet e kontrolleve sa herë që kërkon Kuvendi.

2. Rregullimi i brendshëm dhe tagri shtesë i Vëzhguesit të Përgjithshëm përcaktohen me ligj.

#### **Neni 153. Emërimi dhe mandati**

1. Vëzhguesin e Përgjithshëm e emëron Prijetari me miratimin e shumicës së të gjithë ligjvënësve në Kuvend.

2. Vëzhguesi i Përgjithshëm shërben për pesë vjet. I njëjti qytetar mund të riemërohet Vëzhgues i Përgjithshëm vetëm një herë.

#### **Neni 154. Shkarkimi**

1. Prijetari ose një e treta e ligjvënësve mund t'i kërkojë Kuvendi ta shkarkojë Vëzhguesin e Përgjithshëm.

2. Kuvendi e shkarkon Vëzhguesin e Përgjithshëm me shumicën e dy të tretave të të gjithë ligjvënësve.

### **PJESA 4. ORGANE TJERA**

#### **Neni 155. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i pavarur dhe i përhershëm, i cili organizon zgjedhjet dhe referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.

2. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë. Gjashtë togjet më të mëdha të ligjvënësve emërojnë nga të paktën një anëtar. Emërimi i anëtarëve tjerë rregullohet me ligj.

3. Kryesuesin e Komisionit e emëron Prijetari nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës së Naltë dhe gjykatave ankimore.

#### **Neni 156. Banka e Dardanisë**

1. Banka e Dardanisë është banka qendrore e shtetit dhe ngrehim i pavarur dhe i rregulluar me ligj që ka të drejtën përjashtuese:

(1) me pre monedhën dardane;

(2) me zbatu pavarësisht politikën monedhare; dhe

(3) me mbajtë dhe mbarështu kursimet valutore të shtetit.

2. Për punën e vet, Banka e Dardanisë i përgjigjet vetëm Kuvendit.

**Neni 157. Komisioni i Medieve**

Komisioni i Mediave është organ i pavarur dhe i rregulluar me ligj që:

- (1) rregullon valët të transmetimit;
- (2) jep leje për transmetuesit botorë dhe privatë;
- (3) përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit; dhe
- (4) bart përgjegjësi tjera sipas ligjit.

**Neni 158. Agjencitë e pavarura**

1. Agjencitë e pavarura janë organe të pavarura dhe profesioniste të themeluara me ligj për të bartë përgjegjësi mbarështuese sipas një udhëzimi të qartë.
2. Agjencitë e pavarura kanë buxhetin e tyre dhe e mbarështojnë atë mëvetësisht, sipas ligjit.
3. Çdo zyrtar, organ shtetëror, ose autoritet tjetër ka detyrë të bashkëpunojë me agjencitë e pavarura dhe t'u përgjigjet kërkesave që ato bëjnë brenda fushëveprimit të tyre.

**Neni 159. Papajtueshmëria**

Drejtuesit dhe zyrtarët e lartë të organeve të përcaktuara me këtë pjesë nuk mund të ushtrojnë veprimtari politike.

## **KREU IX. MBROJTJA DHE RENDI**

---

### **PJESA 1. PARIME TË PËRGJITHSHME**

**Neni 160. Përcaktimi**

1. Organet e mbrojtjes dhe rendit varen nga organet qytetnore dhe demokratike.
2. Kuvendi mbikëqyr, sipas ligjit, buxhetin dhe politikat e organeve të mbrojtjes dhe rendit.

**Neni 161. Detyrat e qytetarëve**

1. Qytetarët dardanë kanë detyrë, sipas ligjit, të mbrojnë vendin dhe të shërbejnë në Ushtri.
2. Qytetari që për arsye ndërgjegjeje nuk pranon me shërby me armë në Ushtri ka detyrë të kryejë një shërbim tjetër sipas ligjit.

**Neni 162. Të drejtat e shërbyesve**

1. Nuk mund të zgjedhen ose të emërohen në detyra të tjera shtetërore dhe as të marrin pjesë në parti ose në veprimtari politike:
  - (1) ushtarakët e shërbimit vepror;
  - (2) pjesëtarët e Policisë; ose
  - (3) pjesëtarët e njësive të inteligjencës.

2. Pjesëtarët e Ushtrisë ose qytetarët që kryejnë shërbim tjetër të mbrojtjes gëzojnë të gjitha të drejtat themelore, përveçse kur ligji parashikon ndryshe.

## **PJESA 2. ORGANET**

### **Neni 163. Ushtria**

1. Ushtria është forcë përgjegjëse për mbrojtjen e vendit. Ushtria përbëhet nga forcat tokësore, ujore, dhe ajrore.
2. Prijetari është kryekomandant i Ushtrisë. Në kohë paqeje, Prijetari drejton Ushtrinë nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes.
3. Prijetari, me parashtrim të Kabinetit, emëron dhe shkarkon Kreun e Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantët e forcave tokësore, ujore, dhe ajrore.
4. Tagri i Prijetarit si kryekomandant i Ushtrisë dhe tagri i komandantëve të Ushtrisë caktohen me ligj.

### **Neni 164. Këshilli i Mbrojtjes**

1. Këshilli i Mbrojtjes është organ këshillues për çështje të mbrojtjes. Ai përgatit strategjinë e mbrojtjes shtetërore dhe bart përgjegjësi tjera të caktuara me Kushtetutë dhe ligje tjera.
2. Këshillin e Mbrojtjes e kryeson Prijetari, në bashkëpunim me Kryeministrin.
3. Mbledhjen e Këshillit të Mbrojtjes mund ta kërkojë në çdo kohë Prijetari, Kryeministri, ose Ministri i Mbrojtjes.
4. Kryeministri dhe Ministri i Mbrojtjes janë anëtarë të Këshillit të Mbrojtjes. Anëtarët tjerë përcaktohen me ligj.

### **Neni 165. Policia**

1. Policia është organ profesionist përgjegjës për të ruajtë rendin dhe sigurinë botore si dhe për të kontrolluar, në bashkëpunim me Ushtrinë, kufirin shtetëror.
2. Policia ka zinxhir të njësuar komande në tërë Dardaninë.
3. Kryeministri emëron Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë.
4. Organizimi i brendshëm i Policisë rregullohet me ligj.

### **Neni 166. Inteligjenca**

1. Agjencia e Inteligjencës është organ profesionist që heton kërcënimet ndaj sigurisë shtetërore.
2. Punën e Agjencisë së Inteligjencës e mbikëqyr, sipas ligjit, Kuvendi.
3. Prijetari, në këshillim me Kryeministrin, emëron drejtorin, zëvendës drejtorin, dhe inspektorin e përgjithshëm të Agjencës së Inteligjencës. Cilësimi dhe mandati i tyre rregullohet me ligj.
4. Prijetari dhe Kryeministri marrin të njëjtat informata të inteligjencës.

## PJESA 3. MASAT E JASHTËZAKONSHME

### Neni 167. Përcaktimi

1. Masat e jashtëzakonshme mund të ndërmerren për aq sa janë të domosdoshme për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore ose teknologjike.
2. Masat e jashtëzakonshme duhet të jenë në përpjesëtim me rrezikun dhe të synojnë me rikthyer sa më shpejt gjendjen e rregullt.

### Neni 168. Ligjshmëria

1. Puna e organeve botore, kufizimi i të drejtave themelore, dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara gjatë kohës që ndërmerren masat e jashtëzakonshme rregullohen me ligj.
2. Gjatë kohës sa ndërmerren masat e jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohen:
  - (1) Kushtetuta;
  - (2) ligjet për zgjedhjet për Kuvendin dhe për organet e pushtetit vendor; ose
  - (3) ligjet për masat e jashtëzakonshme.
3. Gjatë kohës sa ndërmerren masat e jashtëzakonshme nuk mund të mbahen zgjedhje të përgjithshme ose referendume. Zgjedhjet vendore mund të bëhen vetëm aty ku nuk zbatohen masat e jashtëzakonshme.

### Neni 169. Gjendja e luftës

1. Në rast agresioni të armatosur kundër vendit, Prijetari, me këshillimin të Kabinetit, shpall me dekret gjendjen e luftës.
2. Brenda 48 orëve pasi nënshkruan dekretin, Prijetari ia paraqet atë Kuvendit. Kuvendi menjëherë merr në shqyrtim dekretin dhe e miraton me shumicën e të gjithë ligjvënësve. Dekreti është i pafuqishëm nëse Kuvendi e shqyrton por nuk e miraton atë.
3. Në rast kërcënimesh të jashtme, Kuvendi, me kërkesë të Prijetarit, shpall gjendjen e luftës dhe vendos e heq gjendjen e mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm.

### Neni 170. Gjendja e jashtëzakonshme

1. Në rast rreziku për rendin kushtetutor, Kabineti mund t'i kërkojë Kuvendit të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme në një pjesë ose në krejt vendin. Gjendja e jashtëzakonshme zgjat për aq kohë sa vijon rreziku, por jo më shumë se 60 ditë.
2. Me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, Ushtria ndërhyt vetëm me vendim të Kuvendit dhe kur Policia nuk është në gjendje të rivendosë rendin.
3. Kuvendi mund ta zgjasë afatin e gjendjes së jashtëzakonshme për 30 ditë me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve, por jo më shumë se tri herë.

**Neni 171. Gjendja e fatkeqësisë**

1. Për të parandaluar ose mënjanuar pasojat e një fatkeqësie natyrore ose teknologjike, Kabineti mund të shpallë gjendjen e fatkeqësisë në një pjesë ose në krejt vendit. Gjendja e fatkeqësisë shpallet për një afat deri në 30 ditë.
2. Kuvendi mund ta përmbysë vendimin e Kabinetit me shpallë gjendjen e fatkeqësisë.
3. Gjendja e fatkeqësisë mund të zgjatet vetëm me pëlqimin e Kuvendit.

**Neni 172. Kufizimi i të drejtave**

1. Gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme nuk mund të kufizohen të drejtat e parashikuara nga nenet 13, 14, 15, 16, 17, 18, 21, 27, 28, 29, 30, 31, 35, 36, 40, 48, 50, 51, 52, 59, dhe 60, me përjashtim të paragrafëve 35.4, 48.3, 52.2(4), 60.1, dhe 60.3.
2. Gjatë gjendjes së fatkeqësisë mund të kufizohen:
  - (1) paprekshmëria e banesës;
  - (2) liria e lëvizjes;
  - (3) e drejta e shpërblimit në rast shpronësimi; dhe
  - (4) e drejta për grevë.
3. Aktet për ndërmarrjen e masave të jashtëzakonshme duhet të cilësojnë të drejtat që kufizohen sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni.

**Neni 173. Pushteti ligjvënës**

1. Kur Kuvendi nuk mund të mblidhet gjatë gjendjes së luftës, Prijetari, me këshillim të Kabinetit, ka të drejtë të nxjerrë akte që kanë fuqinë e ligjit.
2. Aktet e nxjerra sipas këtij neni humbin fuqinë nëse Kuvendi nuk i miraton në mbledhjen më të parë.

## **KREU X. SHQITJE TJERA**

---

### **PJESA 1. MARRËDHËNIE EKONOMIKE**

**Neni 174. Rendi ekonomik**

1. Rendi ekonomik mbështetet në ekonominë e tregut, konkurrencën e lirë, dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike.
2. Shteti kujdeset për mirëqenien e përgjithshme:
  - (1) duke nxitë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe punësimin qytetarëve;
  - (2) duke mbrojtë investuesit dhe pronën;
  - (3) duke mbrojtë, sipas ligjit, konkurrencën e lirë;

- (4) duke mbrojtë konsumatorët dhe huamarrësit;
- (5) duke themeluar organe të pavarura për rregullimin e tregut kur vetë tregu nuk është në gjendje ta mbrojë interesin botor; dhe
- (6) duke marrë masa me pengu shtrenjtimit afatgjatë të mallrave dhe shërbimeve.

#### **Neni 175. Financat**

1. Çdonjëri nën tagrin e Dardanisë ka detyrë t'i paguajë tatimet dhe detyrimet financiare të përcaktuara me ligj.
2. Shteti mbledh dhe shpenzon mjete pasurore sipas ligjit, haptazi, dhe sa më efektshëm.
3. Organet shtetërore japin llogari për shpenzimet e tyre. Huatë shtetërore rregullohen me ligj.

#### **Neni 176. Të mirat e veçanta**

1. Populli ka të drejtë të gëzojë burimet dhe pasuritë natyrore të vendit. Ato përfshijnë, por jo vetëm, ujërat, hapësirën ajrore, pasuritë minerare, tokën, pyjet, botën bimore e shtazore, si dhe tjera të mira të veçanta të përcaktuara me ligj.
2. Rregullohen me ligj kufizimet e të drejtave mbi të mirat e veçanta dhe kompensimi për kufizimet e tilla.

## **PJESA 2. ÇËSHTJE KOMBËTARE**

#### **Neni 177. Logu Kombëtar**

1. Logu Kombëtar është organ këshillues për çështjet që kanë të bëjnë me Kombin Shqiptar, përfshi bashkëpunimin mbarëkombëtar dhe mbrojtjen e interesave të shqiptarëve jashtë Dardanisë.
2. Logun Kombëtar e kryeson Prijetari, në bashkërendim me Kryeministrin.

#### **Neni 178. Këshilli i Kombësive**

1. Këshilli i Kombësive është organ që mbron pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e pjesëtarëve të kombësive në ligje, qeverisje, dhe punësim.
2. Këshillin e Kombësive e drejton Prijetari.

## **PJESA 3. PUSHTETI VENDOR DHE NDARJA TOKËSORE**

#### **Neni 179. Përcaktimi**

1. Qeverisja vendore mbrohet dhe rregullohet me ligj dhe mbështet në zgjedhje të lira e të drejtpërdrejta.
2. Nuk mund të ketë kurrfarë njësie sovrane përpos shtetit.
3. Njësitë e qeverisjes ose ndarjes tokësore nuk mund të themelohen:
  - (1) në vija kombësish ose prirjesh politike a ideologjike; ose
  - (2) brenda hapësirave tokësore të shkëputura, të shkapërderdhura, ose të lidhura mes vete përmes korridoreve.

**Neni 180. Bashkitë**

1. Bashkia është njësi themelore e ndarjes tokësore dhe qeverisjes vendore.
2. Bashkitë kanë tagër që, sipas ligjit:
  - (1) të nxjerrin urdhëresa e të marrin vendime brenda fushëveprimit të tyre;
  - (2) të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe me palë të treta brenda e jashtë shtetit; dhe
  - (3) të mbledhin, caktojnë, dhe shpenzojnë të hyra si dhe të marrin fonde nga qeveria qendrore.

**Neni 181. Trevat**

1. Treva është njësi e ndarjes tokësore, e rregulluar me ligj për qëllime të mbarështimit shtetëror.
2. Trualli i një treve ngërthen në tërësi një ose më shumë bashki.

**Neni 182. Organet qendrore**

1. Organi qendror që i dërgon bashkisë përgjegjësi të posaçme mbulon shpenzimet që rrjedhin prej asaj përgjegjësie.
2. Organet qendrore rishikojnë aktet që bashkitë nxjerrin brenda fushëveprimit të tyre vetëm për përputhje me ligj.
3. Organet qendrore drejtojnë të gjithë veprimtarinë e trevave.

**PJESA 4. PARIME SHITESË TË QEVERISJES****Neni 183. Orari i zgjedhjeve**

1. Zgjedhjet e rregullta për Prijetar dhe zgjedhjet vendore mbahet të njëjtën ditë.
2. Zgjedhjet e rregullta për Kuvend mbahen dy vjet para ose pas zgjedhjeve të rregullta për Prijetar dhe zgjedhjeve vendore.
3. Referendumi, për aq sa është e mundshme, mbahet të njëjtën ditë me zgjedhjet e parapara për atë vit.
4. Për ta zbatuar paragrafin 2, Prijetari mund ta shkurtojë deri në një vit mandatin e vet, të ligjvënësve, ose organeve të qeverisjes vendore.

**Neni 184. Ecuria zgjedhore**

1. Vota e qytetarit mund t'i njetet vetëm kandidatit që zgjedh qytetari. Vota ose mandati i fituar nuk mund t'i njeten togut ose partisë politike në të cilën bën pjesë kandidati.
2. Çdo qytetar ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës me shqyrtu mbarëvajtjen e zgjedhjeve.

**Neni 185. Formula e betimit**

1. Prijetari, ligjvënësit, dhe anëtarët e Kabinetit bëjnë këtë betim: «Beto hem se do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve tjera të vendit, do të respektoj të drejtat themelore të secilit, do të mbroj pavarësinë e Dardanisë, dhe do t'i shërbej të mirës së përgjithshme dhe përparimit të popullit tonë».

2. Gjyqtarët bëjnë këtë betim: «Betoem se do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve tjera të vendit, do të mbroj të drejtat themelore të secilit dhe sovranitetin popullor, dhe do t'i shërbej pa kusht drejtësisë dhe së mirës së përgjithshme».

3. Zyrtarët tjerë betohen, sipas formulës së caktuar me ligj, se do t'i binden Kushtetutës dhe ligjeve tjera të vendit dhe do ta kryejnë me besnikëri detyrën që pranojnë.

#### **Neni 186. Rroga e zyrtarëve**

1. Nuk mund t'i ulet rroga gjatë kohës sa shërben gjyqtarit, përndjekësit, ose zyrtarit të lartë të një organi të pavarur dhe jopolitik.

2. Rrogat e gjyqtarëve, përndjekësve, dhe zyrtarëve të lartë të organeve të pavarura rriten çdo vit në përputhje me shtrenjtimin e përgjithshëm të mallrave dhe shërbimeve.

## **PJESA 5. REFERENDUMI**

#### **Neni 187. Kërkesa dhe shpallja**

1. 50 mijë qytetarë, një e katërta e të gjithë ligjvënësve, ose Kryeministri mund të kërkojnë referendum për ta miratuar ose shfuqizuar një ligj ose për çështje me rëndësi të posaçme.

2. Mbajtjen e referendumit e miraton Prijetari ose Kuvendi.

#### **Neni 188. Rishikimi gjyqësor**

1. Pasi të miratojë mbajtjen e referendumit, Prijetari ose Kuvendi njofton Gjykatën Kushtetutore për çështjen që do të shtrohen në referendum.

2. Brenda 60 ditëve vijuese, Gjykata Kushtetutore e parandalon referendumin nëse vlerëson se çështjet e shtruara nuk janë në pajtim me Kushtetutën; nëse jo, ia paraqet vlerësimin e vet Prijetarit.

3. Gjykata Kushtetutore nuk shqyrton nëse çështja e shtruar është e rëndësisë së posaçme.

#### **Neni 189. Zhvillimi i referendumit**

1. Ditën që merr vlerësimin e Gjykatës Kushtetutore ose brenda 14 ditëve vijuese, Prijetari thërret referendumin. Referendumi mbahet brenda një viti pas ditës që e thërret Prijetari.

2. Çështja e shtruar quhet e miratuar kur për të votojnë shumica e të gjithë qytetarëve me të drejtë vote.

#### **Neni 190. Shpallja**

1. Ligjin e miratuar me referendum e shpall Prijetari ditën që vërtetohet rezultati i referendumit ose brenda shtatë ditëve vijuese.

2. Nëse Prijetari nuk shpall ligjin, ligji vetëshpallet shtatë ditë pas ditës që vërtetohet rezultati i referendumit.

#### **Neni 191. Kufizime**

1. Nuk mund të shtrohen në referendum çështjet që kanë të bëjnë me:

(1) tërësinë tokësore të Dardanisë;

- (2) kufizimin e të drejtave themelore;
- (3) buxhetin;
- (4) tatimet e detyrimet financiare të shtetit;
- (5) vendosjen ose heqjen e masave të jashtëzakonshme;
- (6) shpalljen e luftës ose bërjen e paqes; ose
- (7) faljen.

2. Referendumi për të njëjtën çështje mund të mbahet vetëm një herë brenda tri vjetëve.

## **PJESA 6. NDRYSHIMI I KUSHTETUTËS**

### **Neni 192. Nisma dhe miratimi**

1. Mund të parashtrojë ndryshimin e Kushtetutës kushdo që ka të drejtë t'i parashtrojë Kuvendit një ligj për shqyrtim dhe miratim.
2. Çdo ndryshim i Kushtetutës bëhet me ligj kushtetues, i cili përtërësohet në Kushtetutë me të hy në fuqi.
3. Ligjin kushtetues e miraton Kuvendi me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve.

### **Neni 193. Rishikimi gjyqësor**

1. Pasi ta miratojë ligjin kushtetues, Kuvendi ia paraqet atë Gjykatës Kushtetutore.
2. Brenda 30 ditëve vijuese, Gjykata Kushtetutore vlerëson nëse ligji pakëson të drejtat themelore ose sovranitetin e popullit dhe:
  - (1) nëse vlerëson se po, e kthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend dhe cek arsyet pse po e kthen ligjin; ose
  - (2) nëse vlerëson se jo, ia paraqet ligjin Prijetarit.

### **Neni 194. Rimiratimi**

1. Nëse Gjykata Kushtetutore e kthen ligjin, Kuvendi mund ta rimiratojë, me pesë të shtatat e të gjithë ligjvënësve, ligjin të pandryshuar.
2. Pasi ta rimiratojë ligjin, Kuvendi ia paraqet atë Prijetarit.

### **Neni 195. Shpallja**

1. Ditën që i paraqitet ligji kushtetues ose brenda shtatë ditëve vijuese, Prijetari shpall ligjin.
2. Nëse Prijetari nuk shpall ligjin, ligji vetëshpallet shtatë ditë pas ditës që i paraqitet Prijetarit.

## **PJESA 7. KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

### **Neni 196. Emërtimi i vendit**

Emërtimet "Dardania," "Republika e Kosovës," dhe "Republika e Kosovës dhe Metohisë" janë të barasvlershme për aq sa i referohen një vendi ose shteti të pavarur.

**Neni 197. Ligjshmëria**

1. Shfuqizohet në tërësi Kushtetuta e Republikës së Kosovës e miratuar më 2008.
2. Ligjet tjera mbeten në fuqi për aq sa janë në pajtim me këtë Kushtetutë dhe nuk janë ndryshuar ose shfuqizuar.
3. Çështjet kalimtare rregullohet me ligj të veçantë për zbatimin e Kushtetutës. Ai ligj miratohet në të njëjtën mënyrë si Kushtetuta dhe nuk i nënshtrohet rishikimit gjyqësor.

**Neni 198. Hyrja në fuqi**

Kjo Kushtetutë hyn në fuqi ditën që e shpall Prijetari.